



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të neneve 12.2 shkronja c dhe 40.2 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 4 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204, nenit 2.1 të Ligjit nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe neneve 15.2 shkronja c dhe 34.2 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-1/298-10, të datës 12.10.2009, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2015, miratoi këtë,

### **RREGULLORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2016**

#### **Neni 1**

1.1. Duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit nr 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme, caktohet baza tatimore.

#### **Neni 2**

2.1 Duke u bazuar në vendndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Podujevës janë përcaktuar 4 zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara.

#### **Neni 3**

Sipas zonave vlera e tregut për m<sup>2</sup> është

##### **3.1. Zona e parë**

Lloji i pronës	Vlera për m <sup>2</sup>
Pronat rezidenciale (banesë-apartament)	360
Pronat rezidenciale-shtëpi	350
Pronat rezidenciale – shtëpi e pa përfunduar 40%	350
Pronat komerciale	650
Pronat komerciale të pashfrytëzuara 70%	650
Pronat industriale	150
Garazh	50
Pronat bujqësore	100
Pronat e braktisura	50
Punishtet	150
Depot	150
Fushat e sportit të mbuluara	100
Fushat e sportit të pambuluara	80
Pishinat	110

### 3.2. Zona e dytë

Lloji i pronës	Vlera për m <sup>2</sup>
Pronat rezidenciale (banesë-apartament)	-
Pronat rezidenciale-shtëpi	280
Pronat rezidenciale-shtëpi e pa përfunduar 40%	280
Pronat komerciale	430
Pronat komerciale të pashfrytëzuara 70%	430
Garazh	50
Pronat industriale	150
Pronat bujqësore	90
Pronat e braktisura.	50
Punishtet	150
Depot	150
Fushat e sportit të mbuluara	100
Fushat e sportit të pambuluara	80
Pishinat	110

### 3.3 Zona e tretë

Lloji i pronës	Vlera për m <sup>2</sup>
Pronat rezidenciale (banesë-apartament)	-
Pronat rezidenciale –shtëpi	230
Pronat rezidenciale-shtëpi e pa përfunduar 40%	230
Pronat komerciale	350
Pronat komerciale të pashfrytëzuara 70%	350
Garazh	50
Pronat industriale	150
Pronat bujqësore	90
Pronat e braktisura.	50
Punishtet	150
Depotë	100
Fushat e sportit të mbuluara	100
Fushat e sportit të pambuluara	80
Pishinat	110

### 3.4. Zona e katërt

Lloji i pronës	Vlera për m <sup>2</sup>
Pronat rezidenciale(banesë-apartament)	-
Pronat rezidenciale-shtëpi	180
Pronat rezidenciale-shtëpi e pa përfunduar 40%	180
Pronat komerciale	200
Pronat komerciale të pashfrytëzuara 70%	200
Garazh	50
Pronat industriale	150
Pronat bujqësore	70

Pronat e braktisura	50
Punishtet	100
Depot	100
Fushat e sportit të mbuluara	100
Fushat e sportit të pambuluara	80
Pishinat	90

#### **Neni 4**

**4.1.** Në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr. 03/L-204 për tatimin ne pronën e paluajtshme, dhe Ligjin nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204, normat e tatimit për vitin tatimor 2016 për Komunën e Podujevës janë si vijon :

Përshkrimi	Norma
Pronat rezidenciale (banesë-apartament)	0.15
Pronat rezidenciale – shtëpi	0.15
Pronat rezidenciale-shtëpi e pa përfunduar 40%	0.15
Pronat komerciale	0.20
Pronat komerciale të pashfrytëzuara 70%	0.20
Garazh	0.20
Pronat industriale	0.20
Pronat bujqësore	0.15
Pronat e braktisura	0.15
Punishtet	0.20
Fushat e sportit dhe pishinat	0.20
Fushat e sportit të mbuluara	0.20

Normat e kualitetit për vlerësim të objekteve bazohen sipas Udhëzimit 03/2011 Bazuar në vlerën e tregut të pronave të paluajtshme, territori i Komunës së Podujevës, ndahet në katër zona tatimore, si vijon:

#### **1. Zona e parë, përfshinë:**

Qendrën e qytetit dhe rrugët : “Afrim Zhitia”, “Ilir Konushefci”, “Hakif Zejnullahu”, “Skenderbeu”, “Ali Ajeti”, “Bahri Fazliu”, “28 Nëntori”, “Zahir Pajaziti”, “Liria”, “Fahri Fazliu”, “20 Qershori”, “Lordi Bajron”, “28 Qeshori”, “Bedri Bajrami”, magjistranja Podujevë-Prishtinë, “Brigadat”, “Vilsoni”, “Agron Rrahmani”, “Anton Çetta”, “Ylfete Humolli”, “Dardania”, “Besnik Restelica”, “Ahmet Haxhiu”, “Avdyl Lahu”, “Hyzri Talla”, “Shaban Shala”, “Drenica”, “Haxhi Sadria”, “Fitorja”, “Gallapi”, “Albaniku”, “Rozafati”, “Ibrahim Demolli”, “Xhekladin Rekalii”, “Dukagjini”, “Hasan Prishtina”, “Hasan Ramadani”, “Vëllezërit Frashëri” “Nazim Gafurri”, “Xhafer Meta”, “Llapi” “Qëndresa” objektet në parkun e qytetit , Rruga e Xhamisë, pushimoret në Orllan dhe Barainë.

## **2. Zona e dytë, përfshinë:**

Periferinë e qytetit dhe rrugët: "Abdyl Lahu", "Albaniku", "Ali Ajeti", "Bedri Bajrami", "Besiana", "Besnik Restelica", "Bill Klinton", "Dardania", "Dëshmorët", "Dukagjini", "Emin Duraku", "Fitorja", "Gallapi", "Hakif Zejnullahu", "Hasan Prishtina", "Hasan Ramadani", "Haxhi Sadria", "Hys Popova", "Hyzri Talla", "Ibrahim Demolli", "Ilir Konushëfci", "Ismail Qemaili", "Kongresi i Manastirit", "Lidhja e Prizrenit", "Llapi", "magjistratja Podujevë-Prishtinë", "Merqezi", "Naim Frashëri", "Presheva", "Çamëria", "Qëndresa", "Ramë Govori", "Rozafati", "Skenderbeu", "Sejdi Sekiraqa", "Skenderbeu" Te qershiat, "Tetova", "Teuta", "Vëllezërit Frashëri", dhe "Xhafer Meta".

## **3. Zona e tretë, përfshinë fshatrat:**

Bajçinë, Balloc, Barainë, Batllavë, Bellopojë, Bradash, Dobërdol, Dumnicë e Poshtme, Dumosh, Gërdoc, Gllamnik, Godishnjak, Halabak, Kaçybeg, Katunishtë, Kërpimëh, Kunushec, Letanc, Lladoc, Llapashticë e Poshtme, Llapashticë e Epërme, Llugë, Lluzhan, Lupç i Poshtëm, Lupç i Epërm, Merdar, Metehi, Obranqë, Orllan, Pakashticë e Poshtme, Pakashticë e Epërme Penuhë, Peran, Revuqë, Sallabajë, Sfeçël, Shajkoc, Shakovicë, Shtedim, Siboc i Poshtëm, Siboc i Epërm, Surkish, Tërnavë, Zakut dhe Dobratin.

## **4. Zona e katërt :**

Bëjnë pjesë të gjitha fshatrat rurale të cilat nuk janë të përfshira në zonat paraprake përkatësisht fshatrat: Dvorishtë, Dumnicë e Epërme, Dyz, Bervenik, Bllatë, Barainë, Brainë, Brecë, Herticë, Kalaticë, Kushevicë, Majac, Metergofc, Mirofc, Muhazob, Murgullë, Orllan, Pollatë, Popovë, Potok, Përpellac, Rakinicë, Reqicë, Repë, Sylevicë, Sllatinë, Surdull, Tërnavicë, Turuqicë dhe Zhiti.

### **Neni 5.**

**5.1** Pronat të cilat lirohen nga tatimi në pronë e të cilat janë të cekura në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Podujevës.

### **Neni 6**

**6.1** Shtyrja e pagesës të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme.

### **Neni 7**

**7.1** Në pajtim me nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ 05/2011, neni 1, Kryetari i Komunës emëron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2016.

### **Neni 8**

**8.1** Me Ligjin nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë dhe Udhëzimet administrative rregullohen të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore të Komunës.

## **Neni 9**

**9.1** Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme, nr. 01-400-82172 e datës 29 shtator 2014.

## **Neni 10**

**10.1** Rregullorja hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-400-85811**  
**Podujevë,**  
**30 shtator 2015**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**